



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2023:021773

Datë: 17.04.2024

Numri i dokumentit: 05583509

**C-IV.-16-0334**

*Ankuesi:*

**M A**- nga Prishtina.

*E paditura:*

1. **N.SH “Urata”** e përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, Rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë;
2. **V A** nga f.sh Sh K.Podujevë,
3. **I K** nga Obiliqi, që të dy ish punëtor të paditurës së parë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Murat Hulaj, pas seancës dëgjimore të mbajtur me dt. 05.03.2024, pas analizimit dhe vlerësimit të provave dhe vendimarrjes së datës **20 mars 2024**, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

1. **REFUZOHET** si e pa bazuar ankesa dhe **VËRTETOHET**, vendimi i Autoritetit të Likuidimit të AKP-së nr.PR.N103-0010 i dt.25 korrik 2013, përkitazi me N.SH “Urata” e përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit.
2. **LEJOHET** tërheqja padisë së paditësit M A e paraqitur kundër të paditurit V A, për kompensimin e dëmit.
3. **Dhoma e Posaçme i Gjykatës Supreme (DHPGJS) shpallet si gjykatë JO KOMPETENTE LËNDORE** në këtë çështje kontestimore e cila udhëhiqet me shenjen C-IV-16-0334, sipas padisë së paditësit M A ndaj të paditurit I K për kompensim dëmi, për shkak të mungesës së Juridiksionit të Dhomës së Posaçme për ta trajtuar.

4. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, lënda dhe shkresat të lëndës nënë shenjen C-IV-16-0334, referuar te paditurin e pikës 3 (tre), në afat prej 3 ditë, ti dërgohen në kompetencë të mëtejme, Gjykatës Themelore-Prishtinë.

5. Palët e pakënaqura ndaj këtij Aktgjykimi kanë te drejtë të ushtrojnë ankesë ne afatin prej 15 ditësh pas marrjes se këtij aktgjykimi ne Kolegjin e shkallës se dytë të Dhomës se Posaçme, e përmes shkalles së I-rë të DHPGJS.

6. Ankuesi ka paguar taksen gjyqësore dhe nuk ngarkohet me taksë shtesë.

### **Rrethanat faktike dhe procedurale**

Me datën 29 korrik 2013 ankuesi ish punëtor i NSH “Urata” ka ushtruar ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovë (DHPGJS) kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit (më tutje AL) nr. PRN103-0010 i dt.25 korrik 2013, me të cilin ka kërkuar kompensim për lëndimet e shkaktuara në vendin e punës në shumë prej 8,100.00 Euro.

Ankesën e ka ushtruar edhe kundër të paditurve V A nga fshati Sh K.Podujevë,

3. I K nga Obliqi, për shkak të kompensimit të dëmit. Në ankesë ka pohuar se refuzimi i kërkesës së tij, është i pa bazë, për arsye se me kohë e ka bërë kërkesën. Ankesës i ka bashkangjitur: Kopjen e vendimit të atakuar, Njoftimi i AKP-së, Njoftimi për likuidim i AKP-së.

Ankuesi përmes parashtresës së daten 13 mars 2014, ka bërë dorëzimin e aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë P.nr.1055/06 dt.02.02.2007, formular i kërkesës për likuidim në emër të ankuesit.

Me datën 08 maj 2014 e paditura AKP-ja ka parashtuar mbrojtje në ankesë, në të cilën pohoi se kërkesa është e pa bazuar për shkak se lëndimet e pësuar të ankuesit nuk kanë ndodhur si rezultat i kryerjes së rregullt të punës që ankuesi e ka bërë në ndërmarrje, por janë shkaktuar me veprimet e kundërligjshme të personave të caktuar, të cilat janë në procedurë të rregullt gjyqësore dhe janë shpallur fajtor për shaktimin e këtyre lëndimeve. Andaj, as NSH-ja dhe as AKP-ja nuk mund të kenë përgjegjësi për këtë rast, dhe të obligohen për kompensimet e shpenzimeve për këto lëndime.

Ankuesi ka paraqitur përgjigjen e tij me daten 13 qershor 2014, ku ka mbetur në tërësi pranë pretendimeve të parashtruara në ankesë, duke e kontestuar ligjshmërinë e vendimit të AL-së. I ka propozuar gjykatës që ky vendim të anulohet si i pa bazuar dhe të aprovet ankesa e tij.

Gjykata i ka dërguar përgjigjen e ankuesit të paditurës, e cila me daten 09 shtator 2014 ka paraqitur kundërpërgjigjen e saj, duke mbetur pranë mbrojtjes së paraqitur.

Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së me aktgjykimin C-IV.-13-1393 daten 05 Prill 2016, e ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pa bazuar dhe e ka vërtetuar vendimin e AL-së. Ndaj këtij vendimi ankuesi ka paraqitur ankesë dhe Kolegji i Apelit me aktvendimin AC-I-16-0082 të datës

12 korrik 2016 e ka aprovuar si të bazuar ankesën e ankuesit dhe e ka anuluar aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së, duke e kthyer kështu lëndën në rigjykim te kolegji përkatës.

Duke vepruar sipas aktvendimit dhe sugjerimeve të Kolegjit të Apelit të DHPGJS, kjo gjykatë me date 05 mars 2024 ka mbajtur seancë gjyqësore, duke i njoftuar palët ndërgjyqësve. Seanca është mbajtur në këtë datë dhe në të kanë prezantuar ankuesi M A si dhe përfaqësuesja e AKP-së, G K me autorizim në shkresa të lëndës, ndërsa kanë munguar të paditurit V A dhe i paditurit I K të cilët gjykata i kishte ftuar me ftesa, mirëpo nga fletëkthesat ka rezultu se për të paditurin V A, ftesa ishte pranuar me dt. 27.02.2024 dhe nënshkruar nga reja e tij, ndërsa në raport me të paditurin I K ka rezultu konstatimi se adresa është e panjohur.

Gjykata ka vlerësuar se mungesa e tyre nuk është relevante për mos-mbajtje te seances ngase kërkespadija e paditësit e parashtruar konsiston se NSH-Urata përkatësishtë, administrusja AKP-së, ka obligime dhe përgjesi objektive që të përgjigjet për dëmin e shkaktuar, përkatësishtë për kompensimin e dëmit në raport me paditësin në shumën e kërkuar, ku si të paditur te radhes kishte përfshirë edhe 2(dy) të paditurit si ishë puntor te ndërmarrjes.

Ankuesi në këtë seancë ka deklaruar se: Në tërësi qëndrojmë pas padisë sonë me numër C-IV-716/07, të datës 06.04.2007, shkresave, parashtrësive, provave, deklarata tona të dhëna për këtë lëndë të kompensimi të dëmit për lëndimet e shkaktuara në punë dhe detyrat e punës të paditurës së parë N.T.SH “Urata” – Prishtinë, lëndime këto të shkaktuara nga i padituri i dytë V A dhe i padituri i tretë I K që të dy punëtorë të paditurës së parë NSH Urata ish NTSH “Vucar” në Prishtinë, tani e përfaqësuar nga AKP-ja, në veçanti qëndrojmë në tërësi sipas ankesës sonë C-IV-13-1393 të date 26.04.2013, të ushtruar ndaj aktvendimit të DHPGJS-së. I padituri i dytë V A ndërkohë ka vdekur dhe ndaj tij të hiqet padia dhe te orientohet ndaj NTSH Urata – Prishtinë (njësia e likuidimit) dhe të paditurit I K nga Obiliqi ne ..nr... ish punëtor i paditurës së parë, duke kërkuara që padia dhe kërkesëpadija të aprovohet si e bazuar dhe të detyrohet e paditura AL-ja e AKP-së, që paditësit të ja pranoje në tërësi kërkesëpadinë për pagesë të zhdëmtimit në vlerë prej 8100 Euro për lëndime e shkaktuara në punë dhe detyrat e punës te e paditura e parë NTSH “Urata”- Vuçar në Prishtinë, lëndime këto të shkaktuara nga i padituri i tretë I K punëtor i të paditurës së parë. Gjersa ndaj te padituri V A të hiqet padia për shkak te vdekjes se tij pasi qe ka vdekur tani e dy vjet. Bashkë me këtë të bëhen te gjitha pagesat e kërkuara sipas padisë, qe evidentohet me numër C-IV-13-1393. Duke shtuar ne petitum llogaritjen e kamatës ligjore qe nga data e ngritjes se padisë e deri ne përfundimin e vendimit gjyqësor, gjithashtu kërkoje edhe shpenzimet e kësaj procedure qe te detyrohet pala e paditur gjersa ne si paditës te lirohemi nga çdo pagës e kësaj procedure gjyqësorë. Me tutje mbetem në tersi në përmbajnë vazhduese pas petitumit te theksuar ne procesverbal faqe numër 2, sipas përmbajtës vazhduese te dorëzuar me shkrim dhe 3. Deshta të ndalem në pretendimet në dispozita ligjore se përgjegjësia e NSH është përgjegjësi objektive për dëmin që shkaktojnë punëtorët e saj dhe janë te obliguar ta paguaj.

Baza juridike e përgjegjësisë objektive të të paditurës N.SH “Urata” në Prishtinë është përcaktuar: 1. Me dispozitat e nenit 170 par.1, të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve që ka qenë në fuqi në kohën e shkaktimit të dëmit ndaj paditësit. Përkatësishtë i ligjit i vitit 1978 ka qene ligj ne nivel federativ citoj: për dëmin te cilin qe shkaktohet ne pune ose lidhur me punën

dhe i shkakton personit te trete, përgjigjet organizata e bashkuar ku ka punuar punëtori ne momentin e shkakimit te demit përveç se nëse provon se punëtori ne rrethanat konkrete ka vepruar ashtu siç është dashur. Me dispozitat e nenit 152 të ligjit 04/L077 i vitit 2012 i LMD-së e rregullon ne këtë mënyrë. Neni 4 përgjegjësia e punëdhënësit për punëmarrësit neni 152 personi juridik ose fizik, me të cilin punonjësi ka punuar në kohën e shkakimit të demit është përgjegjës për demin e shkaktuar ndaj personi të tretë nga punonjësi gjatë punës apo në lidhje me punën. Përveç nëse provohet se punonjësi ka vepruar ashtu siç ka qenë e nevojshme në rrethanat konkrete. Në dispozitat e punës ne ish shtetin e Jugosllavisë kjo përgjegjësi është rregulluar me dispozitat e nenit 208 dhe 209, ja teksti origjinal i këtyre dispozitave: neni 208 nëse punëtori i shkaktohet dëm në punë apo në lidhje me punën, ka të drejtë që nga organizata themelore të kërkojë kompensimin e demit sipas parimeve të përgjithshme për demin e shkaktuar, nëse organizata nuk e kompenson demin në afatin e paraparë ligjore, punëtori ka drejtë të kërkojë kompensimin e demit në gjykatën e punës së bashkuar. Me dispozitat e ligjit mbi marrëdhënien e punës (tekst i spastruar) i ish Krahinës Autonome të Kosovës me gazetën zyrtare numër 24 te datës 22.06.1984, çështja e përgjegjësise se punëdhënësit ndaj lëndimeve dhe demit te shkaktuar punëtorit i është përcaktuar si ne vijim. Përgjegjësia që i është shkaktuar punëtorit neni 114 organizata themelore i përgjigjet punëtori për demin për shkak te lëndimeve në punë i cili është shkaktuar me fajin e organizatës themelore apo me fajin e personave për të cilët përgjigjet ajo. Organizata themelore i përgjigjet punëtorit për shkak të lëndimeve në punë dhe në rastet edhe kur nuk është fajtor kjo është përgjegjësia objektive e jo personave. Dhe këto pretendime të cilat janë duke i evidentuar në procesverbal janë në ankesën e parë të deponuar me datën 26.04.2016 dhe mbes pranë pretendimeve të tilla.

Përfaqësuesja e të paditurës AKP-së, ka deklaruar se: AL-ja i përmbahet në tërësi qëndrimeve të shprehura në vendimin me numër PRN103-0010, me të cilin është refuzuara, kërkesa e parashtruesit, për kompensimin në vendin punës si e pa vlefshme. Arsyeja, e refuzimit të kërkesës, në këtë çështje gjyqësore pasi qe jemi në shqyrtim të vlerësimi të ligjshmërisë se AL-së, atëherë theksojmë se kërkesa e parashtruesit është refuzuar në bazë të nenit 36.2.2 të shtojcës se ligjit të AKP-së, për shkak së parashtruesi edhe pas kërkesës së AL-së që kërkesa e parashtruesit të plotësohet me dokument shtesë qe do të shkon në pretendimet e vendimit te tij. Ka mbetur përsëri e pa plotë për shkak se parashtruesi nuk ka arritur që të vërtetoj faktin se NSH është përgjegjëse për kompensimin e demit. Pra, në këtë çështje nuk është kontestuese nëse parashtruesit i janë shkaktuar dëmtimeve, por është kontestuese fakti që nëse NSH-ja është përgjigje për kompensimin e këtyre dëmtimeve. Në këtë rast kemi një aktgjykim penal dhe dy personat janë shpallur fajtor dhe kësioj kërkesa e parashtruesi nga ky aktgjykim penal në të cilin dy persona janë shpallur fajtor. Dhe nga aktgjykim palët e vetme përgjegjëse janë gjetur dy personat e cekur dhe asnjë moment nuk është cekur faj apo përgjegjësi e NSH-së. Gjithashtu e kemi edhe aktgjykimin e DHPGJ-së me numër C-IV-13-1393, ku është vërtetuar vendimi i AL-së dhe është vërtetuar se parashtruesi nuk ka pësuar dëme apo si pasojë e neglizhencës të të tjerëve. Dëmet janë shkaktuar si pasojë e dy personave me sjellje kriminale ku NSH-ja nuk është përgjegjëse. Duke u bazuar në këtë që e thamë më lartë AL-ja i propozon gjykatës që vendimin e AL-së edhe njëherë ta vërtetojë si të drejtë dhe të bazuar në ligj, dhe të refuzoj padinë e paditësit si te pa bazuar.

## **Arsyetimi ligjor**

Ankesa e ankuesit refuzohet si e pabazuar dhe Vërtetohet, vendimi i Autoritetit të Likuidimit të AKP-së nr.PRN103-0010 i dates 25 korrik 2013, përkitazi me N.SH “Urata” e përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit.

Në pajtim me nenet 2 pa.4 dhe 77 par.1 pika 1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76 par.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet relevante të lëndës janë të pakontestueshme dhe lëshon këtë aktgjykim pas mbajtjes se seancës dëgjimore.

Neni 154 par.1 i LMD të vitit 1978, i cili ka qenë në fuqi në kohë e shkakimit të dëmit të supozuar sanksionohet kështu “Kush i shkakton tjetrit dëmin ka për detyrë ta kompensojë, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij”.

Neni 195 i po të njëjtit ligj ka parashikuar që “Kush i shkakton tjetrit lëndim trupor ose ia prish shëndetin ka për detyrë t’i kompensojë shpenzimet e mjekimit dhe shpenzimet e tjera të nevojshme lidhur me këtë, si dhe fitimin e humbur për shkak të paaftësisë për punë gjatë kohës së mjekimit.”

Neni 172 i po të njëjtit ligj ka paraparë përgjegjësin e personit juridik për dëmin e shkakuar nga organi i tij, ashtu që par.1 thekson se “Personi juridik përgjigjet për dëmin të cilin organi i tij ia shkakton personit të tretë gjatë ushtrimit ose lidhur me ushtrimin e funksioneve të veta.” Kurse par.2 “Në qoftë se në rastin e caktuar nuk është parashikuar diçka tjetër në ligj personi juridik ka të drejtë kompensimi nga personi që e ka fshehur dëmin me dashje ose nga pakujdesia e fundit.”

Neni 170 par 1 i LMD-së përcakton se “Për dëmin të cilin e shkakton punëtori në punë ose lidhur me punën i shkakton personit të tretë përgjigjet organizata e punës së bashkuar ku ka punuar punëtori në momentin e shkakimit të dëmit, përveç në qoftë se provon se punëtori në rrethanat konkrete ka vepruar ashtu sikundër është dashur.”

Gjykata ka shqyrtuar në tërësi të gjithë materialin e paraqitur në gjykatë nga të dyja palët dhe konstaton se njëra ndër çështjet thelbësore kontestuese, ndërmjet palëve është çështja e përgjegjësisë së të paditurës së parë.

Ankuesi, me parashtrimin e ankesës kundër vendimit të AL-së, nuk ka pohuar ndonjë fakt apo argument ligjor që do të bënin ndryshimin e rrethanave faktike, sa i përket përgjegjësisë objektive të së paditurës së parë dhe kështu për të ndikuar në ndryshimin e vendimit të ankimuar.

Në bazë të provave të deponuara në gjykatë nga pala ankuese, gjykata gjeti se kërkesëpapia e paditësit është e pa bazuar për faktin se deri te lëndimi trupor i ankuesit ka ardhur për shkak të mosmarrëveshjes të cilën e ka pas i njëjtin me të paditurin e dytë dhe të tretë. Kjo provohet me aktgjykimin penal të Gjykatës Komunale në Prishtinë P.nr.1055/06 dt.02.02.2007 ku i padituri i dytë dhe i tretë janë shpallur fajtor për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 153 par.1 pika 4 lidhur me nenin 23 të KPK-së. Askund në këtë aktgjykim nuk arrihet në përfundim se mosmarrëveshja ka ndodhur lidhur me punën dhe detyrat e punës. Ashtu që organizata punues nuk mund të mbahet përgjegjëse pasi që lëndimi i është shkaktuar nga punëtorët e organizatës gjegjësisht NSH-së, por se dëmi nuk i është shkaktuar nga puna ose lidhur me punën.

Gjykata konstatoj se në bazë të dispozitave ligjore të cilat kanë qenë në fuqi në kohën e shkaktimit të lëndimit trupor të dëmtuarit nuk mund të mbahet përgjegjëse e paditura e parë, për faktin se e paditura do të ishte përgjegjëse vetëm në rast se dëmi ankuesit do ti shkaktohej si rezultat i punës ose lidhur me punën.

Gjykata vendosi që lidhur me realizimin e dëmit të pësuar nga i padituri i dytë dhe i tretë, ankuesi duhet të i drejtohet gjykatës së rregullt, për arsye që DHPGJS gjykon vetëm lëndët ku njëra nga palët është NSH. Ashtu që me faktin se NSH, nuk është përgjegjëse për shkaktimin e dëmit të ankuesit, i njëjti për realizimin e kërkesës pasurore juridike lidhur me të paditurin e dytë dhe të tretë do të duhej të i ishte drejtuar gjykatës kompetente të rregullt.

Vendimin sipas pikës 2, te diapozitivit te këtij aktgjykimi gjykata e mori në saje te deklarimit te paditësit ne seancë e në përputhje me dispozitën e nenit 34 par.1, të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme.

Vendimin mbi shpalljen e jo kompetencës lëndore sipas pikës 3 te diapozitivit te këtij aktgjykimi, gjykata e mori në përputhje me atë se sipas të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, neni 5 padia e paditësit për kompensimin e dëmit nuk hynë ne kompetencën trajtuese përkatësisht juridiksionin e përshkruar sipas normimeve te nenit 5 në fjalë, por hynë ne gjykatën e shkalës se parë themelore-Prishtinë ngase kemi te bëjmë me përgjesi individuale për çka Dhoma e Posaçme nuk ka ndonjë eksperiencë në lidhje me ekspertizat e dëmit material dhe jo material e qe këto bien nën domenin trajtues te Gjykatave të rregullta Themelor të shkallës se parë.

Andaj në bazë të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

## **Taksat gjyqësore**

Ankusi tashmë e ka paguar taksën gjyqësore në shumë prej 30 euro, para se te vendoset sipas ankeses nga ana e Kolegjit të apelit të shk.II-të të Dhomes së Posaqme te Gjykates Supreme, e meqe qështja është kthyer ne rivendosje në shkallë te parë (I) të DHPGJS, bazu ne vendimarrjen e Kolegjit te specializuar të shkallës së dytë të datës 12 korrik 2016, ndaj ankusit nuk caktohet taksë e serishme gjyqësore, pasi qe është paguar njiher.

## **Këshilla juridike**

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim tek Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme brenda 15 ditësh nga data e pranimit. Ankesa duhet të parashtrohet në bazë të nenit 9 par.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

**Gjyqtari,**  
*Murat Hulaj*